



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 4017 Prot.

Tiranë, 02. 8.2013

U D H Ë Z I M

Nr. 30, datë 02. 8.2013

PËR RREGULLOREN TIP TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26, pika 2, germa e) e ligjit nr. 69/2102, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

KREU I

TË PËRGJITHSHME

1. Institucioni arsimor parauniversitar funksionon sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullores së tij të brendshme.
2. Rregullorja e brendshme e institucionit arsimor është në përputhje me ligjin nr. 69/2102, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, dhe Dispozitat Normative.
3. Rregullorja e brendshme e institucionit arsimor:
 - a) hartohet, nën drejtimin e drejtorit të institucionit arsimor, nga grupe të gjera pune që përbëhen nga mësues, nxënës, prindër dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti;
 - b) paraqitet për shqyrtim nga drejtori i institucionit arsimor te bordi i institucionit;

- c) paraqitet për miratim nga drejtori i institucionit arsimor tek titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse.
- 4. Nxënësit dhe prindërit e tyre kanë të drejtë të informohen për rregulloren e brendshme të institucionit arsimor. Drejtori i institucionit ka për detyrë të organizojë informimin e tyre.
- 5. Me propozim të drejtorit të institucionit arsimor, të kryetarit të bordit të institucionit arsimor, të këshillit të prindërve, të qeverisë së nxënësve ose të paktën të 1/3-ës së mësuesve me kohë të plotë, nisin procedurat për ndryshimin e neneve ose përfshirjen e neneve të reja në Rregulloren e Brendshme të Institucionit Arsimor.

KREU II

PËRMBAJTJA E RREGULLORES SË BRENDSHME TIP TË INSTITUCIONIT ARSIMOR

Rregullorja e brendshme tip e institucionit arsimor ka përmbajtjen e mëposhtme:

1. Regjistrimi i nxënësve
 - a) Kriteret e pranimit për regjistrim në klasën e parë ose të dhjetë të nxënësve të zonave të tjera.
 - b) Procedura e shortit për pranimet në shkollat profesionale, gjimnazet gjuhësore dhe seksionet dygjuhëshe kur vlera e mesatares së notave të provimeve të lirimt përfshin më shumë nxënës nga sa mund të pranohen.
2. Organizimi në institucionin arsimor
 - a) Përcaktimi i numrit të anëtarëve të drejtorisë së institucionit arsimor.
 - a) Përcaktimi i minutave të pushimit ndërmjet orëve mësimore, 5 ose 10, dhe të pushimit të madh, pas orës së dytë apo të tretë.
 - b) Funksionimi i mësuesve ditor.
 - c) Përcaktimi i numrit të mësuesve, prindërve dhe nxënësve në komisionin e Etikës dhe Sjelljes.
 - d) Përcaktimi i lexuesve të tjerë të bibliotekës së institucionit, përveç mësuesve dhe nxënësve.
3. Siguria, mirëmbajtja në institucionin arsimor
 - a) Veprimet konkrete që kryhen në raste emergjence.
 - b) Procedurat e pranimit të njerëzve të panjohur në mjediset e institucionit.
 - c) Procedurat e mirëmbajtjes rutinë ditore dhe javore të institucionit arsimor.

4. Punonjësi i institucionit arsimor
 - a) Uniforma e punonjësit të institucionit arsimor (drejtuesit, mësuesit, instruktorët)
 - b) Nderime për punonjësit, përveç atyre që përshkruhen në Dispozitat Normative.
 - c) Ndalime për punonjësin e institucionit arsimor përveç atyre që përshkruhen në Dispozitat Normative.


5. Vlerësimi i nxënësve
Procedurat e shortit për vlerësimin vjetor të nxënësve në disa klasa, për disa lëndë.

6. Mësuesi
Detajimi i pikës 2 c të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor prauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

7. Nxënësi
 - a) Veshja e nxënësit në mjediset e shkollës dhe uniforma e tij.
 - b) Nderime të tjera dhe shpërblime për nxënësit, përveç atyre që përshkruhen në Dispozitat Normative.
 - d) Kriteret e shpalljes së pesë nxënësve me rezultate më të larta gjatë vitit mësimor në shkollat profesionale dhe ato të orientuara.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrtat Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

MYQEREM TAJ

